



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 743 Akti

Nr. 662 Vendimi
Tiranë, më 18.5.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Olsi Komici	Anëtar
Suela Zhegu	Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 16.5.2023, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dashamir Alsula**, ndihmës ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Dashamir Alsula, gjatë periudhës së rivlerësimit ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Në zbatim të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në datën 15.6.2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”,

zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Dashmir Alsula do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Olsi Komici, Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes me short u zgjodh komisionere Suela Zhegu.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK).
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 25.6.2021 vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 10.9.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar dhe përbërjen e trupit gjykues, si dhe iu dërgua pyetësi standard, për t'i kthyer përgjigje brenda një afati të arsyeshëm. Ky subjekt nuk konfirmoi marrjen dijeni për këto njoftime, dërguar nga Komisioni.
6. Në vijim, në datën 3.5.2023, subjekti i rivlerësimit u njoftua sërish nga Komisioni nëpërmjet postës elektronike, ku informohet se me njoftimin e datës 10.9.2021 është njoftuar mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi dërgimin e pyetësit standard, përgjigjet e të cilit duhet të ishin dërguar brenda afateve të caktuara nga Komisioni.
7. Subjekti i rivlerësimit, me *email*-in e datës 3.5.2023, konfirmoi marrjen e njoftimeve të Komisionit, përbërjen e trupit gjykues dhe marrjen e pyetësit të dërguar nga Komisioni.
8. I pyetur nga Komisioni në datën 11.5.2023, në lidhje me vijimin e procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit informoi Komisionin, përmes postës elektronike, se nuk ushtron më funksionin e ndihmësit ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Subjekti ka njoftuar se në datën 26.12.2018, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar dorëheqjen e tij nga pozicioni i ndihmësit ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe është emëruar avokat shteti, duke i bashkëlidhur edhe aktet përkatëse këtij *email*-i.
9. Komisioni vlerëson se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka qenë në detyrën e ndihmësit ligjor, detyrë e ushtruar deri në datën 23.12.2018, datë kur ka paraqitur dorëheqjen e tij nga detyra e ndihmësit ligjor dhe, për rrjedhojë, e bën atë subjekt të rivlerësimit *ex officio*, në kuadër të përcaktimit kushtetues në paragrafin 4 të nenit 179/b të Kushtetutës.
10. Statusi i tij si subjekt rivlerësimi ndërpritet vetëm në rast se procesi i rivlerësimit pushon apo ndërpritet, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 56 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin G të Aneksit të Kushtetutës.

11. Komisioni ka administruar urdhrin nr. ***, datë 26.12.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme, për lirimin e tij nga detyra e ndihmësit ligjor, me kërkesën e dorëheqjes së z. Dashamir Alsula, me nr. *** prot., datë 26.12.2018.
12. Në vijim, nga aktet e administruara ka rezultuar se me urdhrin nr. ***, datë 24.12.2018, të Avokatit të Përgjithshëm, z. Dashamir Alsula është emëruar përkohësisht në detyrën e avokatit të shtetit pranë Ministrisë së Brendshme.
13. Pasi ka kaluar të gjitha fazat e zhvillimit të vlerësimit profesional, me urdhrin nr. ***, datë 24.4.2019, të Avokatit të Përgjithshëm, z. Dashamir Alsula është titulluar “Avokat Shteti” dhe është emëruar në pozicionin e avokatit të shtetit pranë Ministrisë së Brendshme.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

14. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar në respektim të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
15. Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:
 - i. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e ndihmësit ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016.
 - ii. Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. ***, datë 26.12.2018, ka miratuar dorëheqjen e z. Dashamir Alsula nga pozicioni i ndihmësit ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme duke sjellë, për rrjedhojë, humbjen e statusit të ndihmësit ligjor.
 - iii. Me urdhrin nr. ***, datë 24.12.2018, të Avokatit të Përgjithshëm, është emëruar përkohësisht në detyrën e avokatit të shtetit.
 - iv. Me urdhrin nr. ***, datë 24.4.2019, është titulluar “Avokat Shteti” dhe është emëruar në pozicionin e avokatit të shtetit pranë Ministrisë së Brendshme.
 - v. Subjekti i rivlerësimit Dashamir Alsula ka paraqitur pranë Komisionit kërkesën për ndërprerje të procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes nga detyra e ndihmësit ligjor.
16. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes¹.
17. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të*

¹ 1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinim me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

18. Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit. 2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1 e ligjit ‘Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit’”.*
19. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.*
20. **Subjekti i rivlerësimit, në datën 11.5.2023**, me anë të postës elektronike, ka njoftuar Komisionin për ndërprerje të procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së tij nga detyra e ndihmësit ligjor dhe për ekonomi të gjykimit të kësaj çështjeje ka shprehur qëndrimin e tij se nuk dëshiron të dëgjohet në seancë dëgjimore.
21. Trupi gjykues mban parasysh jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë humbjen e statusit të tij si subjekt rivlerësimi *ex officio* në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nenit 58, pika 1, nënparagrafët “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës realizohet, përfundimisht, nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016 shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë ndërpret detyrën funksionale që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në të njëjtën frymë arsyeton edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, ku shprehet: *“Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”.*

22. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeht Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga detyra e ndihmësit ligjor. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj duke i kufizuar të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
23. Ky është një qëndrim i unifikuar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vendimmarrje të mëparshme, sipas të cilave orientohet Komisioni që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit sipas nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.
24. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për z. Dashamir Alsula.
2. Ndalimin e emërimit të z. Dashamir Alsula si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 18.5.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha